



Deklarata e Abu Dhabi-it

Deklarata e dalë nga Seanca Pleanre
në Abu Dhabi

Rechnungshof, Dampfschiffstrasse 2,
1031 Vienna · Vienne · Wien · Viena
AUSTRIA · AUTRICHE · ÖSTERREICH · AUSTRIA
Tel. +43 (1) 711 71-8474 | Fax +43 (1) 718 09 69
intosai@rechnungshof.gv.at | www.intosai.org

Deklarata e Abu Dhabi-it

A. Hyrje

1. Në takimin që është mbajtur në Emiratet e Bashkuara Arabe në dhjetor të vitit 2016, Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA) në kongresin e saj (INCOSAI XXII), ka miratuar Deklaratën e Abu Dhabi-it. INCOSAI XXII bazohet në arritjet dhe iniciativat e fundit të ONISA-s, të cilat synojnë aftësimin e ISA-ve që ti ndihmojnë qeveritë e tyre përkatëse në përmirësimin e performancës, rritjen e transparencës, sigurimin e llogaridhënies dhe luftimin e korrupsionit. Deklarata përcakton rezultatet kryesore të Kongresit dhe se si ato do të udhëzojnë ONISA-n në vitet e ardhshme.

2. Deklarata e Abu Dhabi-it është hartuar në kontekstin vijues:

- *Së pari*, procesi gjithëpërfshirës i planifikimit strategjik i ONISA-s i cili rezultoi në një plan të ri strategjik për 2017-2022, me qëllim rritjen e kontributit të ISA-ve për të përmirësuar llogaridhënien dhe transparencën në menaxhimin e financave publike rreth globit;
- *Së dyti*, rishikimi i statuteve të ONISA-s për ti përafuar ato edhe më shumë me strukturën, strategjinë dhe objektivat e tanishme për ti ndihmuar që ti përmbushin nevojat e anëtarëve të saj dhe palëve të interesit;
- *Së treti*, miratimi nga ana e OKB-së të 17 Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ-të) në thelb të Agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, e cila përforcon nevojën dhe kërkesën për auditim dhe shqyrtim të detajuar dhe efektiv publik;
- *Së katërti*, krijimi i një Komiteti për shkëmbim të njohurive brenda Portalit të Komunitetit për të lehtësuar shkëmbimin e njohurive; dhe
- *Së fundi*, miratimi i kornizës së re për deklaratimet profesionale nga ONISA, si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të përmirësuar standardet e ONISA-s dhe procesin e përcaktimit të standardeve.

B. Sigurimi i një zëri global publik

3. ONISA përcakton ambicien e vet për të krijuar një zë global për auditimin publik në Deklaratën e Pekinit të vitit 2013. Kjo ambicie është integruar në planin e sapo-miratuar strategjik 2017-2022, dhe sfidon organizatën tonë për t'u bërë më e shquar dhe të përballet më lehtë nga jashtë.

4. Në nivel global, ONISA është e përkushtuar ndaj forcimit të traditës së saj për sa i përket bashkëpunimit me Kombet e Bashkuara. OZHQ-të i ofrojnë ONISA-s një mundësi të rëndësishme për të thelluar më tej këtë marrëdhënie dhe sigurojnë se komuniteti i ISA-ve

kontribuon me një zë të vlefshëm në nivel global, rajonal dhe nën-rajonal për çështjet që ndërlidhen me kontributet që ISA-të mund të bëjnë për agjendën për zhvillimin e qëndrueshëm të vitit 2030.

5. ONISA është duke formalizuar partneritetin e saj me grupet tjera kyçe të palëve të interesit. Për shembull, puna me Komitetin Drejtues të Donatorëve të ONISA-s për të koordinuar përpjekjet e zhvillimit të kapaciteteve dhe shkëmbimit të mësimave me komunitetin ndërkombëtar për zhvillim. ONISA gjatë disa viteve të ardhshme planifikon të forcojë edhe më tej partneritetin me organizatat ndërkombëtare, përfshirë ato që përfaqësojnë parlamentet, ministritë e financave, organizatat e shoqërisë civile, grupet e biznesit dhe organet profesionale.

C. Dhënia e kontributit të rëndësishëm për Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030

6. Kongresi ka identifikuar rëndësinë dhe interesin në ndërmarrjen e auditimit dhe rishikimit të punës për OZHQ-të, dhe e bën këtë përmes katër qasjeve të ndryshme, siç është elaboruar në planin strategjik. Secila qasje do të mbështetet nga një kornizë e dedikuar e cila do të ndihmojë ONISA-n të përpilojë gjetjet kryesore nga puna e ISA-ve në këtë fushë. Në përgjithësi, ONISA synon të bëhet një zë autoritar i pavarur në lidhje me sfidat me të cilat përballlet komuniteti global në planifikim dhe zbatim të OZHQ-ve dhe raportimin për progresin e tyre.

7. ONISA planifikon të sigurojë informata të rregullta prapavajtëse (*feedback*) për vetë komunitetin tonë në çështjet e kontrollit që ndërlidhen me OZHQ-të, siç janë qasjet, metodologjitë dhe rezultatet, për tu angazhuar, informuar dhe inkurajuar ISA-të që të bëjnë punë efektive në këtë fushë. Përveç kësaj, ONISA do të sigurojë analizë dhe pasqyrë në mënyrë periodike për palët tanë ndërkombëtare të interesit për çështje të kontrollit dhe llogaridhënies lidhur me OZHQ-të, të informuar nga përvoja kolektive dhe puna e ISA-ve. Këto iniciativa kanë për qëllim të jenë demonstrim i efektshëm për rëndësinë dhe dobinë e rolit të ONISA-s dhe output-in e organizatave anëtare të saj.

8. Për të ndjekur ambiciet tona për Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, ONISA do të formojë një grup ekspertësh të udhëhequr nga Kryesuesi i ONISA-s dhe i cili raporton në Komitetin Mbikëqyrës për Çështjet e Reja (KMÇR). Ky grup, i cili do të përbëhet nga ekspertë të brendshëm dhe të jashtëm, do të mbikëqyr zhvillimin dhe zbatimin e kornizave. Këtu do të miratojë mënyra të shkathëta dhe të përgjegjshme të punës ku do të përfshijë organet e punës së ONISA-s si dhe burimet tjera të përshtatshme dhe efektive.

9. Kongresi ka identifikuar këto objektiva kryesore që grupi i ekspertëve ti adresojë në periudhën që shkon deri në INCOSAI-XXIII 2019:

- Zhvillimi dhe ofrimi i kornizave për zbatimin e katër qasjeve që bazohen në iniciativat e ISA-ve, si dhe mekanizmi për monitorimin e progresit dhe mbledhjen e të dhënave;

- Mbështetja e prodhimit të informacionit me cilësi të lartë lidhur me OZHQ-të përmes këtyre kornizave, dhe shkëmbimi i tyre me komunitetin e ISA-ve; dhe
- Sigurimi i marrëdhënieve efektive me OKB-në dhe partnerë të tjerë të jashtëm, përfshirë raportimin informativ dhe të qasshëm dhe maksimizimin e vlerës së simpoziumeve të ardhshme të ONISA/OKB-së për temën në fjalë.

10. Qëllimi i përgjithshëm i ONISA-s është të mbështesë ISA-të që të japin kontribut vendimtar në suksesin e agjendës 2030, dhe në këtë mënyrë të ndihmojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve në mbarë botën.

D. Profesionalizimi

11. Qytetarët janë përfituesit e fundit të auditimit publik. Është detyra e ISA-ve të kryejnë auditime të cilësisë më të lartë dhe ti ofrojnë qytetarëve raporte që mbështesin transparencën, llogaridhënien e mirë dhe besimin në qeveri. Vetëm puna më e mirë mund të bëjë ndryshim të vërtetë në jetën e tyre. Për ta, ONISA duhet të avancojë më tej ambiciet e saj të profesionalizimit.

12. Profesionalizimi është proces i vazhdueshëm me të cilin individët dhe organizatat e tyre fitojnë nivele të larta të pavarësisë, ekspertizës, kompetencës, sjelljes etike dhe cilësisë, mbështetur nga standardet profesionale.

13. Dhënia e kontributit vendimtar në agjendën për zhvillim të qëndrueshëm 2030 kërkon një angazhim nga të gjitha pjesët e ONISA-s për të rritur mbështetjen profesionale në dispozicion për të gjithë ISA-të dhe stafin e tyre, duke u mundësuar atyre të ofrojnë produkte përkatëse me kohë, dhe me cilësi të lartë. ONISA e ka adresuar këtë përmes tri iniciativave kryesore:

- Shtimin e përcaktimit të standardeve të ONISA-s;
- Profesionalizimin në nivele globale, rajonale dhe nivele të ISA-ve; dhe
- Ngritjen e kornizës për matje të performancës të ISA-ve.

Shtimi i përcaktimit të standardeve të ONISA-s

14. ONISA ka krijuar Forumin e ONISA-s për Deklarime Profesionale (FODP) dhe ka rishikuar procesin e rregullt për kornizën e deklarimeve profesionale (KODP) të ONISA-së. Ekspertët teknik të FODP-së kanë përgjegjësi të përgjithshme për përmbajtjen, konsistencën dhe cilësinë e KODP-së. FODP forcon ONISA-n si përcaktuese e standardeve ndërkombëtare dhe kontribuon në zhvillimin e standardeve të përshtatshme për auditimin e sektorit publik.

15. Proceset e përcaktimit të standardeve të ONISA-s duhet të ndihmojë në sigurimin që ISA-të të kenë qasje në cilësi të lartë, standarde të auditimit të njohura ndërkombëtarisht. Fokusi i vazhdueshëm në përmirësimin e cilësisë së deklarimeve profesionale dhe proceset e përcaktimit të standardeve do të ndihmojnë në përmbushjen e misionit të ONISA-s për të nxitur zhvillimin e kapaciteteve të ISA-ve dhe përmirësimin e performancës. ONISA do të luajë rol aktiv në promovimin e përdorimit dhe zbatimit të SNISA-ve.

Profesionalizimi në nivele globale, rajonale dhe të ISA-ve

16. ONISA, duke punuar ngushtë me Iniciativën për Zhvillim të ONISA-s (IZHO), do të zgjerojë më tej përpjekjet e saj në nivele globale, rajonale dhe në nivel të ISA-ve për të mbështetur profesionalizimin e vazhdueshëm të ISA-ve dhe stafit të tyre.

17. Në nivel global, FODP ka identifikuar nevojën për të forcuar përpjekjet e ONISA-s drejt kompetencave, aftësive profesionale, etikës, vlerave dhe qëndrimeve për auditorët e sektorit publik në kornizën e ONISA-s për deklaratimet profesionale. Grupi punues i kryesuar nga KNK do të vazhdojë të shqyrtojë mundësitë më të mira për krijimin e një themeli të fortë për të përforcuar edhe më tej kompetencat dhe aftësitë e auditorëve të sektorit publik.

18. Për të lehtësuar zbatimin e produkteve teknike të ofruara në nivel global, është e rëndësishme që organizatat rajonale të ONISA-s të vazhdojnë të luajnë një rol kyç në komunikim nga niveli global deri te ai i ISA-ve, dhe anasjelltas. Shtatë organizatat rajonale të ONISA-s, së bashku me strukturat e tyre nën-rajonale ka qenë një pikë qendrore e zhvillimit të ONISA-s gjatë tre viteve të fundit. KNK ka krijuar Forumin Rajonal për Zhvillim të Kapaciteteve e që i dedikohet angazhimeve me organizatat rajonale dhe nën-rajonale.

19. Në nivel të ISA-ve, iniciativat për zhvillim profesional nga institucionet individuale mbeten të rëndësishme për arritjen e niveleve më të larta të profesionalizimit. Këto përfshijnë: zbatimin rigoroz të standardeve të ONISA-s; forcimin e etikës dhe integritetit; dhe trajnimin e vazhdueshëm profesional si për Menaxhmentin ashtu edhe për stafin.

Ngritja e kornizës së matjes së performancës së ISA-ve

20. Në INCOSAI-XXII është miratuar Korniza për Matje të Performancës së ISA-ve (KMP) për përdorim në ONISA si mjet gjithëpërfshirës për vlerësim bazuar në dëshmi të performancës së ISA-së dhe për identifikimin e mundësive për përmirësim. ONISA në mënyrë aktive inkurajon përdorimin e kornizës që është i zbatueshëm për të gjitha llojet e ISA-ve, pavarësisht nga modeli organizativ, mandati, konteksti kombëtar dhe niveli i zhvillimit.

E. Zbatimi i Planit Strategjik të ONISA-s 2017-2022

21. Plani i ri strategjik i organizatës sonë mbulon shumë nga ambiciet e ngritura nga Kongresi dhe të pasqyruara në këtë Deklaratë të Abu Dhabi-it. Udhëheqësia e ONISA-s duhet të sfidojë organizatën tonë për të përmbushur këto ambicie në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe efikase.

22. Bordi qeverisës, me ndihmën e Komitetit të Përhershëm për Çështjet e Reja, të katër Komisionet kryesore dhe Sekretariati i Përgjithshëm luajnë rol thelbësor në monitorimin e progresit për përmbushjen e planit strategjik dhe përcjelljen sipas nevojës.

23. KMÇR do të monitorojë prioritetet ndër-sektoriale të ONISA-s për të siguruar që ato plotësisht dhe në mënyrë të vazhdueshme integrohen në strategjitë dhe programet e ndryshme të ONISA-s në bazë të objektivave strategjike.

24. Në INCOSAI-XXIII në vitin 2019 do të dorëzohet një raport i llogaridhënies për aktivitetet e ndërmarra dhe më e rëndësishmja për shkallën në të cilën ONISA ka përmbushur qëllimin dhe frymën e prioriteteve ndër-sektoriale, qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në planin strategjik.